KONKURS

Për regjistrimin e nxënësve në vitin e parë për vitin shkollor 2025/2026

I. Me Konkursin për regjistrimin e nxënësve në arsimin e mesëm në vitin shkollor 2025/2026 është përcaktuar mundësia për regjistrimin e nxënësve sipas planeve dhe programeve mësimore për gjimnaz. Në përputhje me nenin 42 të Ligjit për Arsimin e Mesëm („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut " nr. 44/1995, 24/1996, 34/1996, 35/1997, 82/1999, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 67/2004, 55/2005, 113/2005, 35/2006, 30/2007, 49/2007, 81/2008, 92/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016, 67/2017dhe 64/2018) dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 229/2020), Ligjit për Arsim Profesional dhe Trajnim („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 71/2006, 117/2008, 148/2009, 17/2011, 24/2013, 137/2013, 41/2014, 145/2015, 55/2016dhe 64/2018 dhe („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 275/2019) dhe Ligjit për Akademinë e Sportit („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 115/2014, 129/2015, 146/2015, 30/2016 dhe 142/2016dhe 64/2018) dhe Ligjin për Gjimnazin Matematikë-Informatikë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 64/2018), regjistrimi i nxënësve në shkollat e mesme publike realizohet në bazë të Konkursit të cilin e shpall Ministria e Arsimit dhe Shkencës në mjetet e informimit publik me propozim të komunave. Me Konkursin për regjistrimin e nxënësve në arsimin e mesëm në vitin shkollor 2025/2026 është përcaktuar mundësia për regjistrimin e nxënësve sipas planeve dhe programeve mësimore për gjimnaz, (drejtimi matematiko - natyrore - (kombinimi A), drejtimi matematiko - natyrore - (kombinimi B), drejtimi shoqëroro - humanitar (kombinimi A), drejtimi shoqëroro - humanitar (kombinimi B), drejtimi gjuhësor - artistik (kombinimi A), drejtimi gjuhësor - artistik (kombinimi B).

SHMK Gjimnazi „SAMI FRASHËRI" Kumanovë

Në vitin e parë do të regjistroj **238 nxënës në 7 paralele** me mësim në gjuhën shqipe sipas planeve dhe programeve mësimore si vijojnë: **Gjimnaz – 238 nxënës, 7 paralele, minimum 60 pikë** .

II.KUSHTET DHE KRITERET E REGJISTRIMIT PËR PËRZGJEDHJEN E NXËNËSVE

Kushtet për regjistrimin e nxënësve në vitin e parë ne gjimnaz janë:

- të kenë përfunduar arsimin fillor;
- të mos jenë mbimoshën 17 vjeçare;

Kriteret për përzgjedhjen e nxënësve janë:

- suksesi mesatar i nxënësit nga klasa e VI deri në të IX;
- suksesi mesatar i nxënësit të arritur në këto lëndë (gjuhë amtare, gjuhë e huaj dhe dy lëndë të rëndësishme për profesionin);
- diploma për vendet e fituara (I, II dhe III) nga konkurset ndërkombëtare, si dhe konkurset shtetërore (të organizuara nga shoqata të akredituara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës) në gjuhën amtare, gjuhë të huaj, shkencat natyrore, matematikë, kimi, fizikë, biologjinë dhe gjeografi dhe lëndët që janë të rëndësishme për profesionin përkatësisht fushën zgjedhore;
- vlera mesatare e pikëve të fituara për sjelljen nga klasa VI deri në klasën IX.

Transport falas ose akomodimi të nxënësve të cilët do të regjistrohen në vitin e parë në shkollat e mesme publike, nuk do të sigurohet nëse lloji i zgjedhur arsimor (profesioni ose drejtimi) ekziston në komunën, përkatësisht rajonin nga vjen.

Në shkollat ku aplikojnë një numër i madh i nxënësve që i plotësojnë kushtet e parapara në këtë konkurs, organizohet një test kualifikues nga materiali mësimor nga klasa e tetë - nëntë në lëndët vijuese: - gjimnaz – gjuhë amtare dhe matematikë.

Për suksesin mesatar nga klasa VI deri në klasën IX nxënësi mund të marrë më së shumti 50 pikë (suksesi i përgjithshëm nga klasa e gjashtë, shtatë, tetë dhe nëntë, mblidhet, pastaj pjesëtohet me katër dhe i njëjti numër shumëzohet me koeficientin 10).

Për suksesin mesatar të arritur nga katër lëndët e propozuara (dy lëndë mësimore të detyrueshme për të gjitha llojet e arsimit dhe dy lëndë të rëndësishme për profesionin), nxënësi mund të marrë më së shumti 20 pikë (5 pikë për secilën lëndë).

Për vendin e fituar në Gara ndërkombëtare dhe shtetërore nxënësi mund të fitojë:

- Për vend të fituar në Garat ndërkombëtare 5 pikë,
- Për vend të fituar në garat shtetërore të akredituara-3 pikë për vendin e I - rë, 2 pikë për vendin e II-të dhe 1 pikë për vendin e III-të.

Për vlerën mesatare të pikëve për sjelljen nga klasa VI në klasën IX, nxënësi mund të marrë më së shumti 5 pikë.(Sjellja shembullore vlerësohet në 5 pikë, sjellja e mirë vlerësohet në 3 pikë dhe sjellja jo e kënaqshme vlerësohet në 0 pikë.
Vlera mesatare është shuma e pikëve për sjelljen e klasës së gjashtë, të shtatë, të tetë dhe të nëntë, e ndarë me 4). Numri i përcaktuar i pikëve minimale për aplikimin e parë është pjesë përbërëse e këtij konkursi.

III. DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR REGJISTRIM

Gjatë aplikimit , nxënësit të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- aplikimi për regjistrim (aplikimi për regjistrim përgatitet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit);
- dëftesa origjinale nga klasa VI deri në klasën IX;
- diploma, (nëse ka) nga vendet e fituara (I, II dhe III) nga garat ndërkombëtare dhe shtetërore në gjuhë amtare, gjuhë të huaj, shkencta natyrore, matematikë, kimi, fizikë, biologji dhe gjeografi si dhe lëndët mësimore që janë të rëndësishme për profesionin, drejtimin, përkatësisht në fushën zgjedhore;
- çertifikata nga libri amë i lindjes (pavarësisht nga data e lëshimit).

IV. AFATET E KONKURSIT

Regjistrimi i nxënësve do të bëhet përmes aplikimit elektronik, përmes linkut në portalin për shërbime elektronike të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës https://e-uslugi.mon.gov.mk me paraqitje speciale për nxënësit e shkollave të mesme përmes llogarive të tyre të përdoruesve të Schools.mk.

- **AFATI I QERSHORIT PËR REGJISTRIM :**

***Paraqitja e parë elektronike** e nxënësve do të bëhet prej orës **00:00 të datës 14 qershor deri ora 23:59 të datës 17 qershor 2025.**

-**Dorëzimi i dokumentacionit të nevojshëm në shkolla** është me datë **18 qershor 2025 nga ora 08:00 deri ora 19:00 si dhe 19 qershor 2025 prej ora 08:00 deri në orën 17:00.**

-**Renditjen përfundimtare me rezultatet nga regjistrimi dhe vendet e lira**, secila shkollë e publikon më **20 qershor 2025, më së voni deri në ora 12:00**, në vend publik në shkollë dhe/ose në ueb faqen e shkollës.

-**Testi kualifikues** do të organizohet në shkollat për arsim të mesëm më **23 qershor 2025**, ndërsa renditja përfundimtare me rezultatet do të publikohet më **23 qershor 2025** në vendin publik në shkollë ose në ueb faqen e shkollës.

***Paraqitja e dytë elektronike** e nxënësve do të bëhet prej më **30 qershorë 2025 prej ora 00:00 deri në ora 23:59.**

-**Dorëzimi i dokumentacionit** të nevojshëm në shkolla është më **1 korrik 2025 prej ora 10.00 deri në ora 19:00**

-**Renditja e listës përfundimtare me rezultatet e regjistrimit dhe vendet e lira**, secila shkollë do ta publikojë më **02 korrik 2025**, **më së voni deri në ora 12:00** në vend publik në shkollë dhe/ ose në ueb faqen e shkollës.

-**Testimi kualifikues** do të organizohet në shkollat e mesme në datën **4 korrik 2025**, ndërsa listat përfundimtare të renditjes me rezultatet do të publikohen më 4 korrik 2025, në vend publik të shkollës.

- **AFATI I GUSHTIT PËR REGJISTRIM :**

-Nxënësit të cilët dërgohen në riprovim korrigjues, provim vjetor, provime për përparim më të shpejtë, mund të regjistrohen në shkollat ku ka vende të lira dhe i plotësojnë kushtet e parapara nga Konkursi, pas afatit të qershorit me dy paraqitje.

- **Regjistrimi** i nxënësve do të bëhet më datë **21 gusht prej ora 00:00 deri në orën 15:00**.

- **Dorëzimi i dokumentacionit** të nevojshëm në shkolla bëhet me datë **21 gusht prej ora 08:00 deri në orën 17:00.**

- **Lista përfundimtare me rezultatet e regjistrimit**, secila shkollë do ta publikojë më **22 gusht 2025, më së voni deri ora 10:00.**

Pas publikimit të rang listave përfundimtare me rezultatet e regjistrimit, nxënësit që nuk janë regjistruar në shkollë, janë të detyruar të marrin të gjithë dokumentacionin e dorëzuar gjatë paraqitjes në shkollë në afat prej 24 orëve, ndërsa shkollat janë të obliguara t'ua kthejnë të gjithë dokumentacionin nxënësve në afat prej 24 orëve.

Drejtori

_____

Nagri Rexhepi